



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Nr...6092... Prot

Datë .....11/07...../ 2023



**POSTA SHQIPTARE SHA**

Nr...1425... Prot

Datë .....11/07...../ 2023

# **MARRËVESHJE**

**PËR**

**PAGESËN E PENSIONEVE DHE PËRFITIMEVE TË TJERA**

**NGA SIGURIMET SHOQËRORE**

**DHE ARKËTIMIN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE**

**SHOQËRORE**

**DHE SHËNDETËSORE**

Kjo Marrëveshje, lidhet në Tiranë, sot më 11/07/2023, ndërmjet palëve, si më poshtë:

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 05.06.1992 “Për krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, me seli në adresën: Rruga e Durrësit, Nr. 83, Tiranë, Shqipëri, dhe me NIPT J726240021L, ligjërisht e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Astrit HADO (më poshtë referuar edhe si ISSH)

*Dhe*

**Posta Shqiptare sha**, person juridik i organizuar, që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në adresën: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr.4, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Regjistrat Tregtar, në përputhje me Vendimin Nr. 20718, datë 27.01.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT J61924007N, përfaqësuar nga z. Ardit DEMIRI, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë (më poshtë referuar edhe si Posta).

## **PREAMBULA**

Meqenëse ekzistojnë kushtet:

1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik, i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ka si qëllim menaxhimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe dhënien e përfitimeve për kategoritë përfituese.
2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka misionin e administrimit të sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti.
3. Posta Shqiptare sha është një shoqëri tregtare që operon në tregun e shërbimeve financiare, e licensuar nga Banka e Shqipërisë si institucion financiar dhe si institucion i Parasë Elektronike, për të ushtruar të gjitha veprimtaritë financiare dhe bankare të përcaktuara në të, në përputhje me dispozitat e Rregullores së Bankës së Shqipërisë dhe konform kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë.

4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore i beson Postës Shqiptare sha shërbimin e pagesës së pensioneve dhe të përfitimeve të tjera në qytete dhe në fshatra, gjithashtu dhe shërbimin e arkëtimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore, vullnetare dhe të detyrueshme, nëpërmjet zyrave Postare.
5. Posta Shqiptare sha merr përsipër të kryejë shërbimin e pagesës së pensioneve, kompensimeve apo përfitimeve të tjera, të akorduara nga ligje apo vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet zyrave ku ushtron aktivitetin e saj.
6. Posta Shqiptare sha disponon burimet, mjetet, logjistikën, mundësinë e shtrirjes territoriale, për kryerjen e shërbimit të pagesës dhe shpërndarjes së fondeve të pensioneve.
7. Për zbatimin e kësaj Marrëveshje, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ngarkon Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore në rrethe (më poshtë të quajtura DRSSH dhe ALSSH), ndërsa Posta Shqiptare sha ngarkon Filialet / Degët e saj.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sha bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje:

## **PËRKUFIZIME**

Në këtë Marrëveshje bashkëpunimi përkufizimet e mëposhtme do të kenë këtë kuptim:

1. **“Përfitues”** janë të gjithë përfituesit, të cilët përfitojnë fondet që Instituti i Sigurimeve Shoqërore akordon në zbatim të Ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të dispozitave të tjera ligjore, mbi përfitime të ndryshme që përcaktohen me ligje apo vendime të Këshillit të Ministrave.
2. **“Ofruesi i Shërbimit”** është Shoqëria Posta Shqiptare sha, e cila merr përsipër ofrimin e shërbimit të pagesës së fondeve të pensioneve dhe kategorive të tjera të përfitimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet shtrirjes së zyrave të saj në zonat urbane dhe rurale.

3. **“Përfitues i Shërbimit”** është Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili është institucioni përgjegjës në këtë Marrëveshje, për akordimin e fondeve, me qëllim pagesën e tyre nga “Ofruesi i Shërbimit”, personave dhe kategorive përfituese.
4. **“Qendër Pagese”** është e përcaktuar zyra Postare e “Ofruesit të Shërbimit”, në të cilin kryhet procesi operacional i pagesës së fondeve të përfitimit.
5. **“Shërbimi i pagesës”** është mundësimi i procesit të pagesave të fondeve të përfitimit të pensioneve nëpërmjet zyrave Postare të Ofruesit të Shërbimit në zona urbane dhe rurale, në përshtatje me organizimin strukturor dhe funksional të tij.
6. **“Shërbimi i arkëtimit”** është procesi i arkëtimit nga klientët të shumave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vullnetare dhe të detyrueshme të bujkut privat, nëpërmjet zyrave Postare të Ofruesit të Shërbimit në zona urbane dhe rurale, në përshtatje me organizimin strukturor dhe funksional të tij, mbështetur në faturën për arkëtim të klientit, të lëshuar nga strukturat e ISSH, DRSSH / ALSSH, në formën e Urdhër – Veprimit.
7. **“Sistemi”** është Sistemi Elektronik i Pagesave i ofruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet të cilit Posta Shqiptare sha do të operojë për procesin e shërbimit të pagesave të fondeve të përfitimit, nëpërmjet zyrave Postare operuese.
8. **“Mandat i pagesës”** është dokumenti që autorizon pagesën, pasi transaksioni i pagesës është procesuar / finalizuar nga sistemi.
9. **“Të dhëna personale”** do të ketë kuptimin e çdo informacioni në lidhje me përfituesit e fondeve, sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar përkatës.
10. **“Informacion Konfidencial”** do të ketë kuptimin e përcaktuar në Nenin 10, të kësaj Marrëveshje.

## **Neni 1**

### **Baza Ligjore**

- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor, që parashikon përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore;
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij;
- Ligji Nr. 9001, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
- Licenca Nr. 46, datë 08.07.2020, e lëshuar nga Banka e Shqipërisë, që autorizon Postën Shqiptare sha të ushtrojë aktivitetin si Institucion i Parasë Elektronike;
- Ligji nr. 46/2015, “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 i “Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM Nr.241, datë 31.03.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sha të shërbimeve Postare, financiare, dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj Poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”, i ndryshuar.

## **Neni 2**

### **Objekti i Marrëveshjes**

**2.1** Organizimi dhe kryerja nga Posta Shqiptare sha e shërbimit të pagesës së fondeve të pensioneve dhe përfitimeve të tjera nga sigurimet shoqërore, të programeve të veçanta të buxhetit të shtetit, pagesën e përfitimeve të tjera si kompensime, shpërblime etj., të akorduara me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, vendime të cilat ngarkojnë ISSH-në dhe Postën Shqiptare sha për zbatim.

**2.2** Arkëtimi nga Posta Shqiptare sha i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vullnetare dhe të detyrueshme, në zonat urbane dhe në zonat rurale, për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe strukturave në varësi të tij.

**2.3** Ky shërbim do të ofrohet në bazë të kuadrit ligjor, rregullave dhe kushteve që janë në fuqi, në përputhje me manualet e shërbimit, politikat dhe rregulloret e të dy palëve.

### **Neni 3**

#### **Tarifat e Shërbimit**

**3.1** Posta Shqiptare sha përfiton komisionin e shërbimit 0.5% mbi shumën e pagesave të kryera gjatë muajit në zyrat e pagesave që ndodhen në qytete, komision i cili paguhet nga ISSH / DRSSH / ALSSH, bazuar në faturimin e kryer nga Posta / Filialet / Degët dhe në Akt – Rakordimin e mbajtur nga të dyja palët mbi pagesat mujore.

**3.2** Posta Shqiptare sha përfiton komisionin e shërbimit 1% mbi shumën e pagesave të kryera gjatë muajit në zyrat e pagesave që ndodhen në fshatra, komision i cili paguhet nga ISSH / DRSSH / ALSSH, bazuar në faturimin e kryer nga Posta / Filialet / Degët e saj dhe në Akt – Rakordimin e mbajtur nga të dyja palët mbi pagesat mujore.

**3.3** Për shërbimin e arkëtimeve të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, komisioni i shërbimit paguhet nga klienti, në momentin e kryerjes së arkëtimit, dhe ky komision vendoset nga Posta bazuar në parimet dhe politikat e saj, mbi vendosjen e komisioneve dhe tarifave.

### **Neni 4**

#### **Detyrime të ISSH / DRSSH / ALSSH**

**4.1** DRSSH / ISSH, është përgjegjëse dhe realizon hedhjen në Sistemin Informatik të Informacionit për përfitimet individuale mujore të caktuara në emër të përfituesit dhe ekspozimit në format elektronik të tyre, nëpërmjet “Mandatpagesës”, e cila plotësohet sipas tipit dhe llojit të përfitimit. Mandatpagesa, e gjeneruar nga Sistemi Elektronik, e cila shërben si akt autorizativ për pagesën e përfitimeve individuale, printohet nga Portali dhe përmban këto të dhëna:

- a. Përfituesin: Emër, Atësi, Mbiemër;
- b. Numrin e dosjes së pensionit;

- c. Numrin e Identifikimit në letërnjoftimin elektronik (Kartën e Identitetit);
- d. Shumat analitike të përfitimeve sipas llojit dhe totalin;
- e. Qendrën e Pagesës (numrin dhe emrin e zyrës paguese);
- f. Nënshkruesit e Mandatpagesës, përfaqësuesit e qendrës së pagesës, marrësi i vlerave monetare.

**4.2** ISSH dhe strukturat e varësisë, në rastet e indeksimit ose rritjes së pensioneve, sipas përcaktimeve në Vendimet e Këshillit të Ministrave, janë përgjegjëse për kryerjen e ndryshimeve të masës së përfitimit individual dhe për pasqyrimin e tyre në Sistemin Informatik të Pagesave.

**4.3** Hedhja në Sistemin Informatik të Pagesave, i shumave të përfitimeve individuale, ndjek procedurat teknike dhe rregullat e poshtëshënuara:

- a. Përfitimet mujore të caktuara, pagesat e të cilëve janë në vazhdim, mbarten në sistem çdo fund muaji - për muajin pasardhës, me kusht që ato të jenë të gatshme për t'u paguar, nga dita e parë e punës e muajit pasardhës;
- b. Përfitimet e reja që caktohen, si dhe rishqyrtimet që kryhen gjatë muajit, hidhen në Sistem në çdo ditë pune, sipas rradhës së punës, të përcaktuar në rregulloret përkatëse të ISSH-së dhe në procedurën teknike të kalimit të përfitimit mujor në Sistemin Elektronik të Pagesave.

**4.4** DRSSH, mbyll në Sistemin Elektronik të Pagesave dhe nuk autorizon kalimin në Portalin e Pagesave, ato përfitime për të cilat, gjatë muajit merret një vendim mbyllje ose pezullimi të pagesës. Mbyllja, pezullimi, rillogaritja e përfitimeve në pakësim të shumës së përfitimit, evidentimi i debitorëve dhe ndalesave nga përfitimi mujor, realizohet në çdo ditë pune, gjatë muajit.

**4.5** Informacioni individual i përfitimeve, hidhet në Sistemin Informatik të Pagesave veçmas për çdo të drejtë mujore të aprovuar, sepse në këtë mënyrë do të autorizohet kalimi në Portalin e Pagesave, do të kryhet pagesa dhe kontrolli për pagesat e kryera. Nuk është e lejuar të krijohen

pagesa përmbledhëse për disa muaj, përveç rasteve të veçanta të diferencave të llogaritura, bazuar në dispozita ligjore të veçanta, apo të vendimeve gjyqësore.

**4.6** DRSSH është përgjegjëse për ndryshimet dhe përditësimet në Sistemin elektronik të Pagesave të përfitimeve individuale, në rastet e pensioneve të mbyllura, të pezulluara, kur pensionisti ndërrohet jetë, apo për transferimet nga një qendër paguese në një tjetër. DRSSH / ALSSH janë përgjegjëse për ndryshimet në Sistemin elektronik të Pagesave, mbi përfitimet afatshkurtra dhe përditësimet e tyre, në respektim dhe në zbatim të afatit të vlefshmërisë së tyre për pagesë.

**4.7** ISSH / DRSSH / ALSSH në bashkëpunim me strukturat e Njësiave Vendore të Gjendjes Civile, kryejnë në kohë përditësimet në Sistemin Informatik të Përfitimeve të mbyllura, mbi personat përfitues, që kanë ndërruar jetë.

**4.8** DRSSH apo ALSSH e rrethit përkatës siguron fondet e nevojshme për pagesën e përfitimeve, dhe i xhiron ato në llogarinë përkatëse bankare të Filialit / Degës së Postës, në formën e paradhënies dhe në formën e likuidimit të shpenzimeve faktike të dokumentuara në raportin analitik të pagesës së përfitimeve, bashkëlidhur mandatet e pagesës, të nënshkruara.

**4.9** ALSSH, për mbulimin e pagesave të pensioneve të ditës së parë të muajit pasardhës, në ditën e fundit të muajit pararendës i xhiron Filialit / Degës përkatëse të Postës, një paradhënie që mbulon pagesat e ditës së parë të punës, në masën jo më pak se 5% të volumit të pagesave mujore, nëse Filiali / Dega e Postës nuk ka gjendje për mbulimin e ditës së parë të muajit.

**4.10** ALSSH e rrethit në datën 1 të çdo muaji, për përgatitjen e likuiditeteve për pagesat e ditës së ardhshme, i xhiron Filialit / Degës së Postës edhe një shtesë paradhënie të barabartë me 5% të fondit të pagesave të programuara. Për raste të arsyetuara, kur kërkesat për paradhënie janë më të mëdha se limitet e përcaktuara, çështja zgjidhet në komunikim midis Dejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

**4.11** ALSSH, nga data 2 deri më datë 25 të muajit, i likuidon për çdo ditë Filialit / Degës së Postës Shqiptare sha, shpenzimet faktike për pagesën e përfitimeve, të kryera në ditën pararendëse,



pas kontrollit të pagesave faktike të kryera nga zyrat postare, të dokumentuara në raportin analitik të shpenzimeve, të cilës së bashku me mandatpagesat e likuiduara bashkëlidhur, vijohen fizikisht nga Filiali /Dega e Postës në DRSSH / ALSSH, duke paraqitur dokumentat jo më vonë se ora 14:00, e ditës së nesërme të punës.

**4.12** Për shpenzimet e kryera e të dokumentuara nga Filiali / Dega e Postës Shqiptare sha, pas datës 25 të muajit, ALSSH bën çdo ditë pakësimin e shkallëzuar të paradhënies mujore, deri në nivelin e mbulimit me likuiditete të pagesave të ditës së parë të muajit të ardhshëm.

**4.13** Nëse shpenzimet faktike të kryera nga Filiali / Dega e Postës Shqiptare sha pas datës 25 e deri në fund të muajit janë më pak se paradhënia e akorduar, diferencën e paradhënies mbi masën e përcaktuar, ALSSH e zbret nga shuma e paradhënies së muajit të ardhshëm, duke bërë shënimin përkatës në urdhër xhirim.

**4.14** Në zyrat e pagesës në qytete, pagesa e pensioneve kryhet çdo ditë, mbi bazën e grafikut të pagesave të caktuar në bashkëpunim me Filialet e Postës dhe të konfirmuara nga ISSH, përjashtuar ditën e fundit të muajit, e përcaktuar për procedurat e gjenerimit të pagesave për muajin pasardhës.

**4.15** Në zyrat e pagesës në fshatra, pagesa e pensioneve fillon pas datës 10 të çdo muaji. Në rastet kur paradhënia e akorduar nuk është e mjaftueshme, ALSSH mund të akordojë një paradhënie shtesë kundrejt shumës së pensioneve për t'u paguar. Kjo paradhënie shlyhet me dërgimin e listëpagesave të pensioneve të paguara, të cilat në varësi të largësisë së qendrës paguese kthehen brenda 5 ditëve pune nga data e tërheqjes së paradhënies, sipas aneksit bashkëlidhur kësaj Marrëveshje, dakordësuar midis palëve.

**4.16** Shpenzimet faktike të kryera, gjendja dhe lëvizja e paradhënies evidentohet çdo muaj me aktrakordim midis ALSSH-së të rrethit dhe Filialit / Degës së Postës, sipas Aneks nr. 2, pjesë e kësaj Marrëveshje.

**4.17** ALSSH, pasi ka bërë evidentimin dhe kontabilizimin e pagesave të muajit, brenda muajit pasardhës njofton Filialin / Degën e Postës Shqiptare sha, për pasaktësitë e gabimet e konstatuara, për pagesa të bëra tepër, pagesa tej afateve, etj, dhe për kthimin e shumave të paguara padrejtësisht.

**4.18** ALSSH e rrethit i paguan në fund të çdo muaji Filialit / Degës së Postës Shqiptare sha një komision shërbimi, mbi shumën e pagesave të kryera gjatë muajit, në qendrat e pagesave që ndodhen në qytete në masën 0.5% dhe në qendrat e pagesës në fshatra 1%, sipas Nenit 3, të kësaj Marrëveshje. Lista e qendrave paguese postare të ndodhura në fshatra, i bashkëlidhet si Aneks kësaj Marrëveshjeje.

## **Neni 5**

### **Detyrime të Postës Shqiptare sha, Filialeve, Degëve dhe Zyrave postare, në varësi të saj**

**5.1** Posta Shqiptare sha merr përsipër të kryejë shërbimin e pagesës së pensioneve, kompensimeve apo përfitimeve të tjera të akorduara nga ligje apo Vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe arkëtimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet zyrave, ku ushtron aktivitetin e saj, konform dispozitave ligjore në fuqi në fushën e arkëtimeve dhe pagesave me fonde publike.

**5.2** Posta deklaron se ajo zhvillon aktivitetin e saj konform të gjitha licensave në fuqi, lëshuar nga çdo autoritet kompetent në Republikën e Shqipërisë, dhe se garanton që të mbajë të vlefshme dhe të ligjshme të gjitha këto licensa, përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.

**5.3** Në respektim të procedurës së autorizimit të pagesës së përfitimit, lidhur me kontrollin para procedimit dhe konfirmimin dhe auditimin pas kryerjes së saj, mandatet e pagesës që vertetojnë tërheqjen e fondeve nga përfituesi, do të jenë të konfirmuara me tre firma, nga të cilat dy nënshkrime janë të përfaqësuesve të qendrës së pagesës (punonjës, përgjegjës i zyrës / degës) dhe një e përfituesit apo marrësit të fondeve.

- 5.4** Filialet / Degët e Postës kryejnë shërbimin e pagesës së pensioneve dhe përfitimeve të tjera për llogari të ISSH-së dhe strukturave të saj dhe DRSSH / ALSSH së rrethit, sipas një grafiku të miratuar nga ISSH, në të gjithë rrjetin ku veprojnë zyrat e tyre, në zonat urbane dhe rurale.
- 5.5** Filialet / Degët e Postës operojnë për kryerjen e pagesave së pensioneve dhe të përfitimeve të tjera dhe për procesin e rakordimeve nëpërmjet Sistemit Informatik të Pagesave të mundësuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- 5.6** Në Zyrat e pagesës në qytete, shërbimi i pagesave të pensioneve ofrohet çdo ditë, përjashtuar ditën e fundit të muajit, e cila shërben për gjenerimin e përfitimeve për muajin pasardhës dhe për kryerjen e proceseve rakorduese, ndërsa në zyrat e pagesës në fshatra shërbimi i pagesës fillon jo më vonë se data 10 e çdo muaji.
- 5.7** Bazë për kryerjen e pagesës është Mandatpagesa, e cila është ngarkuar në Sistemin Elektronik të Pagesave nga DRSSH, e adresuar në emër të përfituesit dhe të Zyrës Postare të Pagesave. Mandatpagesa elektronike është një akt autorizativ, e cila pasqyron shumat mujore të përfitimeve, të adresuara si e drejtë e përfituesit.
- 5.8** Mbi bazën e Mandatpagesës, shumat e përfitimeve të autorizuara i paguhen përfituesit nga personeli i autorizuar i Zyrës postare, me paraqitjen e tij ose të personit të autorizuar prej tij dhe pas paraqitjes së dokumenteve individuale të identifikimit, letërnjoftimi elektronik ose pasaporta biometrike.
- 5.9** Në rastin e tërheqjes së pensionit nga një person i autorizuar nga pensionisti, dokumentacioni që paraqitet dhe procedurat janë ato të përcaktuara në Nenin 7 “Dispozita të Përbashkëta”, të kësaj Marrëveshjeje. Në mandatpagesën, ku nënshkruan marrësi i autorizuar i fondeve, shënohen edhe lloji e data e lëshimit të dokumentit autorizues dhe numri i tij i identifikimit.
- 5.10** Për rastet e pensioneve familjare të caktuar për fëmijë të mitur ose për persona të cilësuar me zotësi të kufizuar, si dokument autorizues i tërheqjes së pensionit, njihet edhe vendimi i gjykatës, ku është përcaktuar kujdestari. Identifikimi i personit dhe zbatimi i të gjitha

dispozitave dhe rregullave mbi pagesat është përgjegjësi e personelit të autorizuar të Zyrave Postare.

- 5.11** Pagesa faktike e përfitimit vërtetohet me nënshkrimin e mandatpagesës së printuar, nga përfituesi ose personi i autorizuar prej tij, dhe nga punonjësit e Zyrës postare. Mandatpagesa printohet në tre kopje, nga të cilat kopja e parë mbetet si dokument në Zyrën postare, kopja e dytë është për strukturat e sigurimeve shoqërore dhe kopja e tretë i jepet përfituesit / pensionistit, së bashku me vlerat monetare.
- 5.12** Mbi bazën e pagesave të kryera gjatë ditës, Zyrat postare printojnë nga Sistemi Informatik raportin analitik të pagesave, sipas mandatpagesave të likuiduara, një raport përmbledhës të pagesave, bashkëlidhur kopjet e dyta të mandatpagesave të përfitimeve të paguara. Filiali i Postës, vijon dokumentacionin në DRSSH ose në ALSSH, jo më vonë se ora 14:00 e ditës pasardhëse.
- 5.13** Pasqyra përmbledhëse e shpenzimeve, e nënshkruar edhe nga një specialist i autorizuar i strukturës financiare të Filialit të Postës, të cilës i janë bashkëlidhur mandatpagesat e likuiduara, do të shërbejë për pagesat e kryera si dokumentacion për financimin / likuidimin e fondeve nga DRSSH / ALSSH, për llogari të Filialeve / Degëve të Postës.
- 5.14** Posta, në shfrytëzim të burimeve dhe logjistikës, ofron për përfituesit e pensioneve dërgimin e pensionit në shtëpi, sipas rregullave të caktuara në Rregulloren e saj dhe në respektim të plotë të përcaktimeve të kësaj Marrëveshje.
- 5.15** Për transaksionet e pagesave që kryhen nga Posta për zyrat e qytetit, të cilat i nënshtrohen procesit të kthimit, lejohet anulimi i tyre në Sistemin Informatik të Pagesave, vetëm brenda ditës së punës.
- 5.16** Në zyrat Postare në fshatra, në varësi edhe të organizimit strukturor dhe funksional të shërbimit në këto zona, në rastet kur kthimi i mandateve të paguara dhe të papaguara është i pamundur të kryhet brenda ditës së punës në Zyrë postare, për transaksionet të cilat i

nënshtrohen procesit të kthimit të pagesës, do të lejohet anulimi i tyre në sistem, brenda 5 ditëve pune. Afati i kthimit të pagesave nga Zyrat postare në fshatra përcaktohet në Aneksin bashkëlidhur kësaj Marrëveshje.

**5.17** Zyrat postare kryejnë ndalesa nga përfitimi mujor i pensionistit, në rastet e ndërhyrjes së Zyrave Përmbarimore, për shlyerjen e detyrimit për ushqim, sipas përcaktimeve të parashikuara në pikën 6, të nenit 529, të Kodit të Procedurave Civile. Ndalesat bëhen me mandatarkëtim, evidentohen në kontabilitetin e Filialit / Degës së Postës dhe xhirohen menjëherë në destinacionin e fundit.

**5.18** Posta merr përsipër pagimin e fondeve të përfitimit, të kategorizuara në Sistemin Informatik si Pagesa Afatshkurtra, në të cilën përfshihen fondet e përfitimeve të barrë lindjes dhe fondet e shpenzimeve funerale, për të cilat ndiqet e njëjta procedurë në operativitet dhe në procesin e rakordimit, si për pagesat e pensioneve.

## **Neni 6**

### **Procesi i rakordimit të shërbimit të pagesave të pensioneve dhe përfitimeve të tjera**

**6.1** Zyrat e pagesës, çdo ditë, rakordojnë mbi procesin e pagesave të fondeve të pensioneve dhe përfitimeve të tjera. Në mbyllje të aktivitetit ditor, Zyra postare printon raportin analitik të pagesave dhe e rakordon atë me raportin përmbledhës, bashkëlidh mandatpagesat e nënshkruara dhe një kopje të kësaj praktike e administron në Zyrë postare, ndërsa një kopje e tij vijon si dokumentacion për DRSSH / ALSSH.

**6.2** Filiali / Dega e Postës dhe DRSSH / ALSSH kanë detyrimin e mbajtjes së rakordimit mujor, lidhur me procesin e pagesave të fondeve të pensioneve të muajit pararendës, pagesave afatshkurtra dhe përfitimeve të tjera, të kryera në zyrat e pagesës në qytete dhe në fshatra.

**6.3** Pas rakordimit të pagesave, mbahet dhe hartohet Akt – Rakordimi, sipas Aneks nr.1, në të cilin pasqyrohet totali i pagesave të kryera gjatë muajit, sipas zyrave, dhe përlllogaritja e komisionit

të shërbimit që përfiton Posta, 0.5% mbi totalin e pagesave mujore të kryera në zyrat e qytetit dhe 1% mbi totalin e pagesave mujore të kryera në zyrat e fshatit.

**6.4** Filialet / Degët e Postës, çdo muaj, mbajnë Akt – Rakordimin, sipas Aneks nr. 2, mbi gjendjen e paradhënies në fillim të muajit, financimet e kryera nga DRSSH / ALSSH, shpenzimet e njohura dhe gjendjen e paradhënies në fund të periudhës.

**6.5** Filialet / Degët e Postës, bazuar në Akt - Rakordimin mujor të mbajtur me DRSSH / ALSSH, kryejnë procesin e faturimit të shërbimit lidhur me komisionin e aplikuar, konform procedurave në fuqi mbi fiskalizimin.

**6.6** DRSSH / ALSSH, brenda 15 ditëve nga hartimi i procesit të fiskalizimit, kryen likuidimin e faturës mbi komisionin e shërbimit për pagesat e kryera nga Filiali / Dega e Postës.

**6.7** Filialet / Degët e Postës, brenda muajit janar të vitit pasardhës, kryejnë rakordimin përfundimtar me DRSSH / ALSSH, mbi aktivitetin e pagesave të vitit.

**6.8** Drejtoria e Përgjithshme e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Posta Shqiptare sha, çdo muaj, mbajnë Akt – Rakordimin, sipas formatit të Aneks nr. 2, mbi gjendjen e paradhënies në fillim të muajit, financimet e kryera nga DRSSH / ALSSH, shpenzimet e njohura dhe gjendjen e paradhënies në fund të muajit, sipas ALSSH dhe Degëve të Postës.

## **Neni 7**

### **Dispozita të Përbashkëta**

**7.1** Instituti i Sigurimeve Shoqërore është krijuesi i Portalit të Pagesave të Përfitimeve dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen e tij.

**7.2** Pagesat e Përfitimeve nëpërmjet Portalit të Pagesave kryhen nga operatorët (punonjësit) e Zyrave postare në varësi të Filialeve të Postës Shqiptare sha, e cila është përgjegjëse për

trajnimin e tyre dhe për përdorimin e rregullt të sistemit. Rregullshmëria e pagesave, vijueshmëria e tyre ditore dhe pasaktësitë apo gabimet në pagesat e pensioneve janë përgjegjësi e personelit të Postës Shqiptare sha.

**7.3** Pensioni i paguhet vetë pensionistit, kundrejt paraqitjes së dokumentave personale të identifikimit (letërnjoftim elektronik apo pasaportë biometrike). Pensionistët që jetojnë jashtë shtetit, në mungesë të dokumentave të vlefshëm identifikues (kartë identiteti apo pasaportë e skaduar) paraqesin në sportelet e Postës certifikatën personale të gjeneruar nga portali e-Albania, si dhe dokumentet identifikues të lëshuar nga shteti pritës (Leje qendrimi, pasaportë, apo kartë identiteti e huaj).

**7.4** Kur pensionisti nuk ka mundësi të paraqitet vetë në Zyrën postare për të tërhequr pensionin, ka të drejtë të autorizojë një person tjetër me prokurë. Pensionistët që provohet se jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, ju lejohe të lëshojnë prokurë vetëm me akt noterial.

**7.5** Personi i autorizuar me prokurë për tërheqjen e pensionit të të përfaqësuarit paraqit në qendrat e pagesës këto dokumenta:

- Prokurën e përfaqësimit, e përpiluar me akt noterial, e cila ka afat vlefshmërie 3 vite ose prokurë të hartuar sipas modelit bashkëlidhur Aneksit të kësaj Marrëveshje, e cila ka afat vlefshmërie 6 muaj;
- Dokument identifikimi (letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike);
- Certifikatë personale e pensionistit, e gjeneruar nga portali e-Albania, e cila rinovohet çdo 6 muaj, dhe administrohet në dosjen e prokurës;
- Deklaratë për konfirmimin e të qenit në jetë të pensionistit, me qëllim vijimësinë e pagesës së pensionit, e cila rinovohet çdo 6 muaj dhe administrohet në dosjen e prokurës. Deklarata paraqitet në rastet kur prokura është e hartuar me akt noterial, sipas modelit bashkëlidhur kësaj Marrëveshje.

**7.6** Për tërheqjen e pensionit, kur pensionisti ka lënë shtetësinë shqiptare, si dokument personal identifikimi do të shërbejë pasaporta ose karta e identitetit, të lëshuara nga shteti, shtetësinë e

të cilit ka pensionisti, si dhe dokumenti i lëshuar nga DRSSH-ja që jep përfitimin, në të cilin është i shënuar numri i identifikimit të pensionistit.

**7.7** Përfaqësuesi me prokurë i pensionistit, që ka shtetësi të huaj, paraqet në qendrën e pagesës këto dokumenta:

- Dokument nga DRSSH, ku është shënuar numri identifikimit;
- Prokurë përfaqësimi bërë me akt noterial, me afat vlefshmërie 3 vjet. Në prokurën e përfaqësimit të jetë evidentuar edhe numri i identifikimit të pensionistit, i lëshuar nga sigurimet shoqërore, si dhe kopje të dokumentave identifikues të pensionistit dhe personit të autorizuar prej tij;
- Dokument personal identifikimi;
- Çdo lloj dokumenti që vërteton të qenit në jetë të pensionistit, lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i përkthyer, legalizuar me vulë apostile. Ky dokument përditësohet çdo 6 muaj.

**7.8** Prokura e përfaqësimit, kopja e dokumentit të identifikimit të personit të autorizuar, dhe certifikata personale e pensionistit, deklarata dhe çdo dokument që konfirmon gjallesën, mbahen nga qendra paguese dhe administrohen në dosje te vecanta. Prokurat e hartuara jashtë territorit shqiptar duhet të jenë të hartuara me akt noterial ose pranë strukturave ligjore, të cilat kanë autoritetin e hartimit dhe vërtetimit të tyre. Legalizimi / Apostilimi është i detyrueshëm për të gjitha prokurat e lëshuara nga administrata e një shteti tjetër. Një prokurë që vjen nga jashtë Shqipërisë është e vlefshme ligjërisht kur:

- Është e legalizuar me Vulën Apostile nga strukturat autoritare përkatëse për të kryer këtë veprim juridik, sipas shteteve;
- Është e hartuar dhe e legalizuar nga Përfaqësitë Diplomatike Shqiptare Konsullore në shtetet e huaja, të cilat e bëjnë dokumentin njësoj të vlefshëm si një dokument i hartuar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

**7.9** Zyrat e pagesës mbajnë një databaze, mbi të dhënat e prokurave të përfaqësimit brenda vendit apo jashtë vendit dhe afatet e vlefshmërisë së tyre. Kjo databaze i dërgohet DRSSH / ALSSH, brenda datës 20 janar të vitit pasardhës.



**7.10** Punonjësit e autorizuar të ISSH-së bëjnë kontrollin e pagesave të përfitimeve në Zyrat postare, sipas planeve të kontrollit të miratuar nga drejtori përkatës, të cilat i dërgohen për njoftim Drejtorisë së Filialit / Degës, në raste të veçanta Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare sha dhe sipas autorizimit të nënshkruar nga drejtuesit lokalë të dy institucioneve

**7.11** Strukturat e auditit të ngritura në DRSSH dhe në organet në varësi të tij, kanë të drejtë në çdo kohë të kontrollojnë rregullshmërinë ligjore në kryerjen e veprimeve të pagesave të pensioneve, apo të përfitimeve të tjera pranë qendrave paguese të Postës shqiptare sha. Në përfundim të procesit të kontrollit bëhen akt-auditimet, proces-verbalet, etj, të cilat nënshkruhen nga të dyja palët dhe shkëmbehen. Kopje të akteve ju dërgohen Drejtorisë / Filialit / Degës së Postës.

**7.12** Kur konstatohen dëmtime të fondeve si: pagesë me diferencë të pensioneve, pagesë të pensioneve pas vdekjes etj, nga punonjësit e autorizuar të ISSH / auditit i DRSSH / ALSSH, të cilët auditojnë zbatimin e Marrëveshjes, kanë si detyrim ligjor, që referuar Ligjit të auditit, duhet të njoftojnë për çdo konstatim Drejtorinë e Filialit / Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare sha.

**7.13** Kur nga kontrollet e ushtruara konstatohen dëmtime të fondeve, si pagesë me diferencë të pensioneve, pagesë të pensioneve pas vdekjes etj, bëhet analizë se cilët janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara, dhe nëse Posta Shqiptare sha është përgjegjëse për fondet e dëmtuara, këto i likuidohen DRSSH / ALSSH. Në rastet kur kontrolli i auditit pasqyron:

- a. Për pasaktësitë e gabimet e konstatuara në nënshkrimin e mandatit (mungesa e firmës së pensionistit ose punonjësve përgjegjës) është përgjegjësi e punonjësve të Zyrës postare;
- b. Për pagesat e fondeve të përfitimit, të paguara pa prokurë përfaqësimi, është përgjegjësia e punonjësve të Zyrës postare;
- c. Për pagesa të kryera pas vdekjes së përfituesit, të tërhequra nga i përfaqësuari me prokurë, kur vërtetohet se ky i fundit ka bërë deklaram të rremë gjallëse, përgjegjësia nuk është e Postës. Në këto raste ISSH në bashkëpunim me Postën ndjekin procedurat ligjore (penale e civile) për zhdëmtimin e fondeve.

- 7.14** DRSSH, në rastet e shkronjave (a,b) të pikës 7.14, mban diferencat e dëmtimit të fondeve nga pagesa e ardhshme e radhës së Filialit / Degës. Dëmi i shkaktuar nga ana e punonjësve të Postës, mbahet si debi në dokumentacionin kontabël të Postës.
- 7.15** Konstatimet për dëmtime të fondeve, të nxjerra nga auditi i DRSSH / ALSSH, duhet të konfirmohen nga të dyja palët (DRSSH / ALSSH dhe Drejtoria e Filialit të Postës), si dhe të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Postës Shqiptare sha. Pasi nxirren përgjegjësitë konkrete, Posta duhet të likujdojë fondet e dëmtuara, duke i zbritur nga e ardhura e radhës.
- 7.16** Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në funksion të minimizimit të risqeve mbi pagesat e parregullta, si dhe kontrollit dhe saktësisë së pagesave, çdo përfitim që rezulton i patërhequr mbi një vit, pezullohet përkohësisht nga pasqyrimi në Sistemin Informatik të Pagesave. Me paraqitjen e përfituesit pranë qendrës paguese, filiali i Postës njofton me e-mail Drejtorinë e Përgjithshme të Postës shqiptare sha. Kjo e fundit, nëpërmjet adresës së e-mailit: kontroll\_pagesa\_POSTA@Postashqiptare.al njofton Drejtorinë e Përgjithshme në ISSH në e-mailin kontroll\_pagesa\_ISSH@iss.gov.al. Pas njoftimit me e-mail, ISSH heq pezullimin në mënyrë që Filiali i Postës të vijoje pagesën.
- 7.17** ISSH bashkëpunon me Postën shqiptare sha mbi ndërveprime apo iniciativa, për përshtatjen / ndryshimin / funksionimin / operimin e shërbimit apo mënyrës së pagesës, në përputhje me kërkesat e tregut dhe të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, mbi shërbimin e pagesave të fondeve publike.

## **Neni 8**

### **Shërbimi i arkëtimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore**

- 8.1** Posta Shqiptare sha merr përsipër që bazuar në këtë Marrëveshje bashkëpunimi të ofrojë në sportelet e Zyrave postare në zona urbane dhe rurale shërbimin e arkëtimit nga klientët, të shumave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vullnetare dhe të detyrueshme të bujkut privat, në përshtatje me organizimin strukturor dhe funksional të saj.

- 8.2** Filialet / Degët e Postës / Zyrat Postare, realizojnë arkëtimin e vlerës së detyrimit të faturës, mbështetur në faturën për arkëtim të klientit, të lëshuar nga strukturat e ISSH, DRSSH / ALSSH, në formën e Urdhër - Veprimit.
- 8.3** Me kryerjen e pagesës, Zyra postare pajis klientin me dokumentin Mandat arkëtimi, në të cilin është pasqyruar vlera e detyrimit të paguar nga klienti dhe lloji i kontributit.
- 8.4** Filiali / Dega e Postës ka detyrimin që brenda 2 ditëve nga data e arkëtimit, xhiron detyrimin për llogari të DRSSH / ALSSH.
- 8.5** Filiali / Dega e Postës mundëson me xhirimin dokumentacionin, Urdhër - Veprimin e depozituar nga klienti, kopje të mandatit të arkëtimit dhe raportit analitik, që provon të gjithë veprimet e kryera dhe në emër e për llogari të çdo individi që ka kryer pagesën.
- 8.6** Filialet / Degët e Postës nuk mbajnë përgjegjësi për parregullsi të informacionit, që përmban fatura për arkëtim / Urdhri i Veprimit. Këto problematika zgjidhen mes DRSSH / ALSSH dhe klientit, sipas rastit.

## **Neni 9**

### **Specifikime të operimit të Sistemit Informatik të Pagesave**

- 9.1** Sistemi Informatik dhe Portali i Pagesave të Përfitimeve do të punojë vetëm në intranetin e krijuar midis Postës Shqiptare sha dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Sistemi nuk do të lejohet të aksesohet nga rrjeti publik në internet.
- 9.2** ISSH lejon përdorimin / aksesimin e Sistemit Informatik të Pagesave nga Posta Shqiptare sha:
- Në nivel operacional, për kryerjen e procesit të pagesave dhe të rakordimeve në zyrat e pagesës;
  - Në nivel menaxherial / supervisor për mbikqyrjen e procesit të pagesave, hartimin e raporteve në funksion të proceseve kontrolluese, monitoruese, rakorduese dhe saktësimeve në raportime në strukturat mbikqyrëse nga nivelet manaxheriale.

**9.3** Portali i Pagesave të Përfitimeve do të jetë i gatshëm dhe do të punojë në ditët zyrtare të punës, nga ora 7:00 deri në orën 17:00. Ditën e fundit të punës të muajit, sistemi është i mbyllur dhe nuk hapet për asnjë arsye. Zgjatja e kohës së përdorimit të Portalit të Pagesave të Përfitimeve bëhet me kërkesë të Drejtorisë Qendrore të Postës Shqiptare sha, e cila dërgohet me e-mail, ku përshkruhen edhe arsyet e kërkesës dhe ora, kur do të bëhet mbyllja e portalit. ISSH lajmëron me e-mail mbylljen e portalit në raste të daljeve të akteve nënligjore me efekte të menjëherëshme, që ndikojnë tek përfitimet.

**9.4** Komunikimet në rrjet (network) në lidhjet me Portalin e Pagesave të Përfitimeve, janë përgjegjësi mirëmbajtje dhe administrimi e Postës Shqiptare sha. Në këtë komunikim përfshihen:

- komunikimi në rrjet Posta Shqiptare sha - Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- komunikimi në rrjet Posta Shqiptare sha - Zyrat Postare të pagesave të pensioneve.

**9.5** Caktimi i administratorit të Portalit të Sistemit të Pagesave, krijimi dhe mbyllja e përdoruesve të Portalit të Pagesave të Përfitimeve është përgjegjësi e Postës Shqiptare sha.

## **Neni 10**

### **Ruajtja e Konfidencialitetit dhe Mbrojtja e të dhënave**

**10.1** Konfidencialitet do të thotë çdo lloj informacioni i transmetuar nga njëra palë për palën tjetër, përfshirë informacionet financiare lidhur me këtë Marrëveshje bashkëpunimi. Këto informacione duhet të konsiderohen si rreptësisht konfidenciale nga palët si Posta Shqiptare sha / Filialet / Degët e Postës, që aksesojnë Sistemin e ISSH dhe të dhënat analitike të pensionistëve, ashtu edhe ISSH / DRSSH / ALSSH dhe nuk duhet të bëhen publike tek palët e treta ose të kopjohen nga pala marrëse, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e nevojshme për zbatimin e kushteve të kësaj Marrëveshje.

**10.2** Secila Palë do të sigurohet që vepron dhe do të vazhdojë të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave, të zbatueshëm në Shqipëri,

përfshirë Ligjin shqiptar Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi.

- 10.3** Pala që merr informacionin konfidencial, siguron që punonjësit, të cilëve ju vihet në dispozicion ky informacion, të respektojnë konfidencialitetin, si rrjedhojë e detyrimit ligjor për ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Punonjësit e autorizuar që aksesojnë sistemin e pagesave, duhet të informohen paraprakisht nga Palët, për detyrimin e tyre për mospërhapjen e të dhënave.
- 10.4** Palët bien dakort se nga ana e tyre do të konsiderohet si përhapje edhe nëse Informacioni konfidencial do të përhapet verbalisht, vizualisht apo elektronikisht.
- 10.5** Gjithashtu, secila nga Palët do të garantojë dhe bëjë të mundur që të gjithë punëmarrësit e gjithsecilës palë, të respektojnë konfidencialitetin për çdo dokument apo të dhënë, për të cilën vihen në dijeni gjatë ofrimit të shërbimit.
- 10.6** Palët bien dakord që Posta Shqiptare sha merr përsipër të përdorë informacionin e mësipërm të transmetuar nga ISSH, vetëm për qëllimin e përmbushjes së detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi dhe se nuk do ta përdorë për ndonjë qëllim tjetër apo ta përhapë tek të tretët, pa miratimin paraprak të ISSH - se.
- 10.7** Palët janë të detyruara, sipas këtij Neni, të ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.
- 10.8** Informacion konfidencial nënkupton të gjithë informacionin teknik dhe jo teknik që i transmetohet Sipërmarrësit nga ana e Porositësit, duke përfshirë, por pa u limituar në sekretet tregëtare, informacion mbi pasurinë industriale, teknika, ide, skica, vizatime, modele, procese, paisje, programe software, informacion financiar, lista e konsumatorëve, listat e debitorëve, informacion mbi debitë, kontratat, punonjësit, marrëdhëniet kontraktore, likuidimet e debive, të dhënat personale, si dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me këtë

Marrëveshje apo që Sipërmarrësi vihet në dijeni si rezultat i zbatimit të detyrimeve të kësaj Marrëveshje.

## **Neni 11**

### **Përfaqësimi i palëve në komunikime**

- 11.1** Çdo palë duhet të emërojë ose autorizojë me shkrim një person / persona, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e njoftimeve dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit. Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër brenda 5 ditëve kalendarike për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit / ve të palës.
- 11.2** Çdo kërkesë, njoftim, konfirmim, pretendim, dhe çështje të tjera, në funksion të zbatimit të kësaj Marrëveshje, do të kryhet me shkrim ose në formë elektronike.
- 11.3** Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Palëve do të bëhen me shkrim, përfshirë postën elektronike, dhe do të dërgohen në adresat respektive, në adresat e specifikuara më poshtë:

#### **Për Institutin e Sigurimeve Shoqërore:**

**Znj.Lindita Abdi:** Drejtor i Drejtorisë së Burimeve të Informacionit

E-mail: [lindita.abdi@issh.gov.al](mailto:lindita.abdi@issh.gov.al)

Telefon:0682020856

**Znj Lindita Gjinaj:**Drejtor i Drejtorisë së Financës

E-mail: [lindita.gjinaj@issh.gov.al](mailto:lindita.gjinaj@issh.gov.al)

Telefon:0698025007

#### **Për Posta Shqiptare sha:**

**Znj. Nevila Bejleri:** Drejtor i Shërbimeve Bankare dhe Financiare

E-mail: [nevila.bejleri@Postashqiptare.al](mailto:nevila.bejleri@Postashqiptare.al)

Telefon: 069 22 26 777

## **Neni 12**

### **Kohëzgjatja dhe Zgjidhja e Marrëveshjes**

- 12.1** Kjo Marrëveshje bashkëpunimi është e vlefshme për një afat 1 (një) vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë rinovimi.
- 12.2** Në rast se palët nuk do të kenë ndonjë pretendim lidhur me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, deri jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga përfundimi i saj, Marrëveshja do të mbetet në fuqi edhe pas mbarimit të këtij afati.
- 12.3** Në çdo rast tjetër, afati i paralajmërimit për zgjidhjen e Marrëveshjes do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.
- 12.4** Palët mund të ndërpresin në mënyrë të menjëhershme Marrëveshjen, në rast të mospërbushjeve thelbësore të detyrimeve kontraktore, të parashikuara në të.

## **Neni 13**

### **Forca Madhore**

- 13.1** Mosplotësimi i ndonjë detyrimi, sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk duhet të konsiderohet që është një shkelje e kësaj Marrëveshjeje, për sa kohë që kjo mospërbushje vjen si pasojë e një ngjarje që konsiderohet si Forcë Madhore dhe kur është provuar se Pala e prekur nga kjo ngjarje:
- a. ka marrë të gjitha masat parandaluese të arsyeshme, si dhe të gjitha hapat e nevojshme e të mundshme, për të zbatuar termat dhe kushtet e kësaj akt- Marrëveshjeje; dhe
  - b. ka informuar menjëherë palën tjetër për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.
- 13.2** “Një Ngjarje Forcë Madhore” do të thotë çdo ngjarje ose rrethanë apo kombinim i tyre, që pengon plotësisht apo pjesërisht secilën nga Palët për plotësimin e detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në atë masë që një ngjarje apo rrethanë e tillë është përtej kontrollit të arsyeshëm direkt apo indirekt të Palës së prekur, nuk është shkaktuar nga një

shkelje apo paaftësi e saj, dhe nuk mund të ishte parandaluar nga çfarëdo masë e arsyeshme që kjo palë mund të kishte ndërmarrë.

**13.3** Do të konsiderohen si ngjarje të forcës madhore, katastrofat natyrore, përmytjet, tërmetet, ngjarjet e jashtëzakonshme politike, lufta (dhe ndërhyrjet e paleve të treta që kanë fuqinë e ligjit) dhe çdo ngjarje e njëjtë me to dhe që mund të ndikojë në përmbushjen e objektit të kësaj Marrëveshje, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Marrëveshjes, të cilat kanë të bëjnë me vullnetin e Palëve.

## **Neni 14**

### **Dispozita të fundit**

**14.1** Kjo Marrëveshje do të jetë efektive dhe e vlefshme vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**14.2** Pjesë integrale e kësaj Marrëveshje janë edhe anekset e mëposhtme:

- Aneks 1. Rakordim mujor mbi përlllogaritjen e komisionit;
- Aneks 2. Rakordim mujor mbi Gjendjen e Paradhënies, Filialet e Postës / DRSSH / ALSSH / ISSH dhe Posta Shqiptare sha;
- Aneksi 3. Lista e qendrave paguese të Postës në fshatra;
- Aneks Model - deklarimi mbi konfirmimin e të qenit në jetë dhe vijimësinë e pagesës.

**14.3** Çdo ndryshim në afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshje do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim dhe firmoset nga Palët, në të kundërt ndryshimet do të konsiderohen absolutisht të pavlefshme.

**14.4** Kjo Marrëveshje, me pjesët përbërëse të saj (Aneks 1,2,3) do të interpretohet si një marrëveshje e tërë, në lidhje me çështjen në fjalë. Në rast se ndonjë nen apo frazë është e paqartë, ajo do të interpretohet në kontekstin e marrëveshjes së plotë dhe sipas qëllimeve të palëve.



- 14.5** Posta Shqiptare sha dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, mund të nxjerrin udhëzime të veçanta për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje, nga organet e tyre vartëse.
- 14.6** Respektimi i kushteve të kësaj Marrëveshje, në raste të veçanta, me aprovim paraprak të Drejtorëve të Përgjithshëm respektivë, do të shqyrtohen nga një komision i përbashkët. Rregullat e funksionimit dhe pjestarët e komisionit caktohen me udhëzim të përbashkët.
- 14.7** Palët, në marrëveshje mes tyre, bien dakort për ndryshime të saj, sa herë paraqitet e nevojshme.
- 14.8** Marrëveshjet ISSH - Posta Shqiptare sha Nr. 4537/ 1932, datë 21.08.2008, dhe Nr. 3341 / 3038, datë 12.04.2014, shfuqizohen.
- 14.9** Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, dy për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe dy kopje për Postën Shqiptare sha.
- 14.10** Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën 01 gusht 2023.

**PËR**

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**

**DREJTOR I PËRGJITHSHEM**

**ASTRIT HADO**

**PËR**

**POSTA SHQIPTARE SHA**

**ADMINISTRATOR**

**ARDIT DEMIRI**